



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2022:206410

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05609548

**2022:206410**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.14/24 të datës 17.04.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të përfaqësuesit të të pandehurit në cilësinë e personit juridik, "... " Sh.p.k, av. N. R. dhe të pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës, L. G., me të dëmtuarin J. K., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj: PP/II.nr.1338/22 të datës 06.12.2022, për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.3 lidhur me par.2 dhe nenin 37 të KPRK-së, dhe veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 23.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.14/24 të datës 17.04.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të përfaqësuesit të të pandehurit në cilësinë e personit juridik, "... " Sh.p.k , av. N. R dhe të pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës, L. G.me të dëmtuarin J. K..

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1338/22 të datës 06.12.2022, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit në cilësinë e personit juridik, “3L Guri “ Sh.p.k, me seli në fsh.Nikaj-Kaçanik, me ..., për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.3 lidhur me par.2 dhe nenin 37 të KPRK-së dhe ndaj të pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës L. G. nga fsh...-Kaçanik, i lindur me datë ... me nr.personal: ..., për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.1338/22 të datës 06.12.2022, e ka akuzuar të pandehurin në cilësinë e personit juridik “..” Sh.p k me seli në fsh...j- Kaçanik, për shkak të veprës penale, për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.3 lidhur me par.2 dhe nenin 37 të KPRK-së, dhe të pandehurin në cilësinë e personit përgjegjës, L. G. nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 358 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 17.04.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si: 2022:266776, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata, duke vepruar konform nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që lënda të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 17.04.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit te kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.14/24, në mes palëve në procedurë, dhe ate në mes të përfaqësuesit të të pandehurit në cilësinë e personit juridik, “...” Sh.p.k , av. N. R. dhe të pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës, L. G., me të dëmtuarin J. K.

Andaj gjykata, duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEGA KAÇANIK**

**2022:206410 datë, 23.04.2024**

Sekretarja Juridike  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.